

**GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT,  
SEZONI 2023/2024  
(java e 45-të, deri më 12.11.2023)**


**TË DHËNA JAVORE**

Gjatë javës së 45-të të vitit 2023 (nga 06-12.11.2023), në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 47 raste ( $I=2,6/100.000$  banorë) të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, që është për 3 më shumë krahasuar me javën e kaluar ( $n=44$ ). Krahasuar me javën e njëjtë të sezonit ta kaluar ( $n=15$ ) është regjistruar një rritje prej 3 herë, ndërsa në raport me modelin për 13 sezonet e fundit ( $n=66$ ) është regjistruar një rënie prej 28,7%. (Grafiku 1)

Gjatë javës së 45-të të vitit 2023, pranë laboratorit të virusologjisë të ISHPRMV kanë arritur 31 materiale për analiza laboratorike për gripin, 15 nga mbikëqyrja SARI dhe 16 nga mbikëqyrja e rutinore, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19. Nuk janë regjistruar raste pozitive të gripit dhe për SARS-CoV-2, shtatë persona janë pozitiv për RSV (tek dy është vërtetuar prani e Adenovirus), ndërsa person ka rezultuar pozitiv edhe për Adenovirus edhe për Enterovirus.

Incidenca e raportuar është nën kufirin javor të aktivitetit sezonal të virusit të gripit ( $I=30,6/100.000$ ), pra ende nuk është arritur pragu i hyrjes në sezonin e gripit (Grafiku 1).

**Grafiku 1.** Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike të pritur 2010-2023, sezoni 2022/2023 dhe sezoni 2023/2024



Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 22 persona, nga 0-4 vjet – 13, tek grupmosha nga 5-14 – 8 dhe tek grupmosha mbi 65 vjet 4 persona. Incidencë më e lartë ( $13,5/100.000$ ) është regjistruar tek grupmosha nga 0-4 vjet.

Të sëmurët e kësaj jave janë rastet e para të raportuara gjatë sezonit të ri dhe janë regjistruar në Dibër – 27, Tetovë – 5, Prilep – 4, Kavadar, Kumanovë dhe Strumicë nga 3 dhe Berovë – 2.

### ***Të dhëna kumulative***

**Gjatë sezonit 2023/2024** numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është **287 raste (I=15,6/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=91) numri i rasteve të regjistruara është rritur për për 3 herë, ndërsa krahasuar me modelin e 12 viteve të fundit (n=264) është regjistruar një rritje prej 8,8%.

Raste janë raportuar nga gjithsej 14 QShP/NjR. Numër më i madh i të sëmurëve (142) dhe incidencë më e lartë kumulative (742,2/100.000) është regjistruar në Dibër.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numër më i madh i të sëmurëve janë regjistruar në grupmoshën e cila përfshin pjesën më të madhe të popullatës (15-64 vjet) – 121 (32,1%), ndërsa incidencë më e lartë (60,1/100.000) është regjistruar tek fëmijët në moshë nga 0-4 vjet (n=58).

### **MBIKËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksioneve Respiratore Akute Serioze)**

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si shtesë e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes ndaj gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim që të fitohet informacion më i detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për implementimin në kohë të masave preventive.

Definicioni për rast SARI sipas të cilës zbatohet mbikëqyrja është e harmonizuar me definicionin e rastit nga OBSH-ja që nga viti 2014.

Në vendet sentinel gjatë javës së 45-të janë raportuar gjithsej 26 raste SARI, nga vendet sentinel SARI në Shkup dhe në Shtip. Numri më i madh i rasteve SARI është raportuar nga Instituti për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët KOZLE (n=10; 38,5%). Ndërsa sa i përket moshës, numri më i madh i rasteve SARI (n=16; 61,5%) janë raportuar në mesin e grupmoshës 0-4 vjet.

Gjatë kësaj jave numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 214, pa raste të raportuara në kujdesin intensiv. Nga të gjitha pranimet, 12,1% i përkasin SARI. Ngarkesë më e madhe prej 18,2% vihet re tek grupmosha nga 30-64 vjet.

Kumulativisht gjatë javës së 45-të për analizë laboratorike kanë arritur 15 materiale nga rastet e raportuara SARI, paralelisht të testuara edhe për virusin e gripit, edhe për COVID-19. Janë testuar 13 mostra SARI për virusin sincicial respirator dhe 4 kanë rezultuar pozitive. Tek një mostër është detektuar Adeno virus dhe Enterovirus.

Kumulativisht, nga të gjitha vendet sentinel, janë raportuar gjithsej 170 raste SARI. Numri më i madh i rasteve SARI (nga n=64; 37,6%) janë raportuar në KU e fëmijëve dhe Instituti për sëmundjet e mushkërive tek fëmijët KOZLE. Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshës, numri më i madh i rasteve SARI është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet (n=84; 49,4%).

Kumulativisht numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 1.074, nga të cilët 3 persona janë në kujdes intensiv. Nga të gjitha pranimet, 15,8% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e madhe prej 42,9% vihet re tek grupmosha mbi 65 vjet.

Është regjistruar edhe një rast i vdekjes i raportuar nga SK në Shtip, që i përket grupmoshës mbi 65 vjet, pa komorbiditete dhe pozitiv për COVID-19.

## **MBIKËQYRJA VIRUSOLOGJIKE**

Nga fillimi i sezonit 2023/2024, deri në javën e 45-të, pranë laboratorëve të IShP-së kanë arritur 229 materiale nga institucionet shëndetësore – nga pacientë të trajtuar në ambulantë dhe spitale për analizë për prani të virusit të gripit, nga mbikëqyrja rutinore dhe sentinel SARI.

Kumulativisht, nga mostrat SARI (n=59) janë regjistruar 8 raste pozitive me COVID-19. Në një mostër është vërtetuar Influenza B virus . Nga mostrat SARI 37 janë testuar për virusin sincial respirator, 15 kanë rezultuar pozitive. Tek 5 mostra është detektuar prani e Adeno virus, ndërsa në 1 Enterovirus.

## **VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL**

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i Shëndetit Publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2023 /2024, Ministria e Shëndetësisë siguroi 60.000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 15.000 doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Më datën 25.10.2023 filloi vaksinimi kundër gripit sezonal. Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2023/2024 do të zbatohet në Shtëpitë e Shëndetit dhe/ose Qendrat e Shëndetit Publik me Njësitë e tyre Rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vaksinacija.mk](http://www.vaksinacija.mk).

4.500 vakcina shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të Shëndetit Publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre Rajonale.

**Deri më 08.11.2023 në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 33.406 (95,2%) persona me vaksinat falas, ndërsa 1.696 (4,8%) me vakcina komerciale. Gjithsej janë vaksinuar 35.102 persona.**

## **RAJONI EVROPIAN**

Sipas Raportit të ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary) të publikuar në javën e 44 të vitit 2023, aktiviteti i virusit të gripit është mbi nivelin bazë në 2 vende të Rajonit Evropian të OBSH-së. Krahasuar me javën e 44, virusi i gripit mbetet me aktivitet të ulët, ndërsa aktiviteti i RSV dhe SARS-CoV-2 vazhdon të rritet. Pranimet e reja SARI mbeten në nivel të ulët, ngjashëm me numrin e pranimeve të raportuara gjatë vitit të kaluar, ku numri më i madh i hospitalizimeve ishin si pasojë e SARS-CoV-2.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve infektive**  
**Instituti i Shëndetit Publik**